


01.1820



Në bazë të nenit 21, 22, 44 & 50 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-03, dt. 21.06.2016, nenit 17, pika “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dt.20.02.2008 dhe nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në detyrë zyrtare, me datë 18.03.2025, merr këtë:

V E N D I M

KORRIGJIM I VENDIMIT 05 Nr. 350/02- 71818/23 DT. 20.02.2025, PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR PLOTËSIMIN-NDRYSHIMIN E AKTIT ADMINISTRATIV “VENDIM PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE” 05 Nr.350/02- 71818/23 dt.11.12.2023”

I. Korrigjohet gabimi teknik në Vendimit 05 Nr. 350/02- 71818/23 DT. 20.02.2025, lëshuar nga kjo drejtori, në emër të pronarëve: **Musli Xhemaili, Naser Gashi, Vesel Xhemajli, Muharrem Sylejmani, Nexhmije Krasniqi dhe Sevdije Krasniqi, nga Prishtina, lagjja “Kalabria” p.n. dhe investitorit “Urban A&F Investments” L.L.C nga Vushtrria, rruga “Ukshin Kovaçica” p.n, “Vushtrri”, me certifikatë të regjistrimit të biznesit nr. 811934597, sipas kërkesës 05-350/03-128414/24 dt.30.09.2024 për plotësimin dhe ndryshimin e aktit administrativ Vendimit 05 Nr.350/02- 71818/23 dt.11.12.2023, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektit kryesor për ndërtimin e kompleksit me ndërtesa shumë banesore & afariste – “Ndërtesa 1” me etazhitet 2B+P+7 dhe “Ndërtesa 2” me etazhitet 2B+P+8, në kuadër të parcelave ndërtimore të Blloku urban "B-8" të Planit Rregullues "Kalabria" dhe PZHU-së në Prishtinë, gjegjësisht parcelave kadastrale, nr.07627-4, 07627-3, 07627-2, 07628-37, 07627-41, 07627-42, 07627-43 dhe 07627-44 ZK Prishtinë dhe parcelës kadastrale 7768-2, ZK. Prishtinë, të planifikuar për këmbim.**

- Korrigjimi bëhet në tërë dispozitivin e Vendimit 05 Nr. 350/02- 71818/23 DT. 20.02.2025 dhe te pjesa e arsyetimit, dhe ka të bëjë me:
 - Përshkrimin e zonës kadastrale të parcelës nr.678-0, dhe atë nga: “nr.678-0, ZK.Matiçan” bëhet “nr.678-0, ZK.Çagllavicë”

VII. Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit 05 Nr. 350/02-71818/23 DT. 20.02.2025, për miratimin e plotësimit dhe ndryshimit të kushteve ndërtimore 05 Nr.350/02- 71818/23 dt.11.12.2023”, dhe i njëjti prodhon efekte juridike nga dita e lëshimit të këtij Vendimi.

A r s y e t i m

Drejtorja e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, bazuar në kërkesën 05-350/03-128414/24 dt.30.09.2024 për plotësimin dhe ndryshimin e aktit administrativ Vendimit 05 Nr.350/02- 71818/23 dt.11.12.2023, të kërkuarve: **Musli Xhemaili, Naser Gashi, Vesel Xhemajli, Muharrem Sylejmani, Nexhmije Krasniqi dhe Sevdije Krasniqi, nga Prishtina, lagjja “Kalabria” p.n. dhe investitorit “Urban A&F Investments” L.L.C nga Vushtrria, rruga “Ukshin Kovaçica” p.n, “Vushtrri”, me certifikatë të regjistrimit të biznesit nr. 811934597, me Vendimin 05 Nr. 350/02- 71818/23 DT. 20.02.2025, ka caktuar kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektit kryesor për ndërtimin e kompleksit me ndërtesa shumë banesore & afariste – “Ndërtesa 1” me etazhitet 2B+P+7 dhe Ndërtesa 2” me etazhitet 2B+P+8, në kuadër të parcelave ndërtimore të Blloku urban "B-8" të Planit Rregullues "Kalabria" dhe PZHU-së në Prishtinë, gjegjësisht parcelave kadastrale, nr.07627-4, 07627-3, 07627-2, 07628-37, 07627-41, 07627-42, 07627-43 dhe 07627-44 ZK Prishtinë dhe parcelës kadastrale 7768-2, ZK. Prishtinë, të planifikuar për këmbim.**

Kjo Drejtori gjatë arkivimit të kërkesës ka konstatuar se në Vendimin 05 Nr. 350/02- 71818/23 DT. 20.02.2025, për miratimin e kërkesës për plotësimin-ndryshimin e Aktit Administrativ “Vendim për caktimin e kushteve Ndërtimore” 05 Nr.350/02- 71818/23 dt.11.12.2023, gjatë përshkrimit të parcelës kadastrale nr.678-

0, të planifikuar për këmbim është përvjedhur gabimi teknik dhe zona kadastrale e parcelës nr.678-0 është përshkruar gabimisht ZK. Matëçan në vend të ZK. Çagllavicë;

Andaj, kjo drejtori, duke vepruar konform rregullativës ligjore në fuqi, në bazë të detyrës zyrtare, korrigjon gabimin e lëshuar, sipas përshkrimit në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Bazuar në dispozitat ligjore të përmendura, ky organ vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie, brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimet nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.

I dërgohet: Kërkuarve/investitorit, kësaj drejtorie, Drejtorisë së Inspekcionit, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës **05-350/03-128414/24 dt.30.09.2024** dhe **05 Nr.350/02- 71818/23 dt.05.04.2023**.

I dërgohet përmes postës elektronike: Drejtorisë për Kadastër, dhe Drejtorisë për Planifikim Strategjik të Komunës së Prishtinës.

DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,

05 Nr. 350/02- 71818/23 DT.18.03.2025

Zyrtari,
Anita Osmani

Udhëheqëse e sektorit
Nazife Krasniqi

